



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2023 – Numri: 156

Tiranë – E enjte, 26 tetor 2023

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshilli i Ministrave nr. 600, datë 18.10.2023	Për disa ndryshime në vendimin nr. 422, datë 6.5.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përbërjen, rregullat e funksionimit dhe trajtimin financiar të grupit negociator dhe detyrat e Kryenegociatorit për zhvillimin e negociatave të aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”, të ndryshuar.....	16895
Vendim i Këshilli i Ministrave nr. 604, datë 25.10.2023	Për disa ndryshime në vendimin nr. 113, datë 6.3.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për emërimin e anëtarëve që përfaqësojnë palën shqiptare në Komisionin Shqiptaro-Malazez për Menaxhimin e Ujërave me Interes të Përbashkët”.....	16895
Vendim i Këshilli i Ministrave nr. 605, datë 25.10.2023	Për miratimin e trajtimit financiar të personave përgjegjës për menaxhimin dhe personave përgjegjës për organet mbikëqyrëse të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes sh.a.....	16896
Vendim i Këshilli i Ministrave nr. 606, datë 25.10.2023	Për disa ndryshime në vendimin nr. 595, datë 13.10.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e normave të trajtimit me ushqim të efektivëve ushtarakë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.....	16896

**VENDIM****Nr. 600, datë 18.10.2023**

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 422, DATË 6.5.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRBËRJEN, RREGULLAT E FUNKSIONIMIT DHE TRAJTIMIN FINANCIAR TË GRUPIT NEGOCIATOR DHE DETYRAT E KRYENEGOCIATORIT PËR ZHVILLIMIN E NEGOCIATAVE TË ADERIMIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË BASHKIMIN EVROPIAN”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 23/2015, “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, dhe të vendimit nr. 749, datë 19.12.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e strukturës shtetërore, përgjegjëse për zhvillimin e negociatave dhe lidhjen e traktatit të aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”, me propozimin e ministrit të Shtetit dhe Kryenegociator, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 1, të kreut I, të vendimit nr. 422, datë 6.5.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përbërjen, rregullat e funksionimit dhe trajtimin financiar të grupit negociator dhe detyrat e Kryenegociatorit për zhvillimin e negociatave të aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

a) Fjalët “... - Znj. Romina Kuko, zëvendësministër i Brendshëm...” zëvendësohen me “... - Z. Ilir Beqaj, drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës;”;

b) Fjalët “... - Z. Ilir Bejtja, zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, negociator përgjegjës për kapitullin 15 ...”, shfuqizohen;

c) Fjalët “... - Znj. Enkelejda Muçaj, zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, negociator përgjegjës për kapitujt 14 e 21 dhe bashkënegociator përgjegjës për kapitullin 10 ...” zëvendësohen me “... - Znj. Enkelejda Muçaj, zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjisë,

negociator përgjegjës për kapitujt 14, 15 e 21 dhe bashkënegociator përgjegjës për kapitullin 10.”.

2. Ngarkohen ministri i Shtetit dhe Kryenegociator dhe grupi negociator për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM**Nr. 604, datë 25.10.2023**

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 113, DATË 6.3.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR EMËRIMIN E ANËTARËVE QË PËRFAQËSOJNË PALËN SHQIPTARE NË KOMISIONIN SHQIPTARO-MALAZEZ PËR MENAXHIMIN E UJËRAVE ME INTERES TË PËRBASHKËT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 16, të kreut III, të marrëveshjes kuadër, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Malit të Zi, për marrëdhëniet e ndërsjella në menaxhimin e burimeve ujore ndërkufitare, miratuar me vendimin nr. 745, datë 19.12.2018, të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 113, datë 6.3.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për emërimin e anëtarëve që përfaqësojnë palën shqiptare në Komisionin Shqiptaro-Malazez për Menaxhimin e Ujërave me Interes të Përbashkët”, në pikën 1 të tij, shkronjat “c”, “ç”, “e”, “ë” dhe “f” ndryshohen, si më poshtë vijon:

“c) Z. Armand Skapi, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme;

ç) Z. Klodian Zaimi, Instituti i Gjeoshkencave;

...

e) Znj. Sonila Marku, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar;

ë) Znj. Evis Mellonashi, Agjencia Kombëtare e Mjedisit;



f) Z. Besmir Kullolli, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile”.

2. Ngarkohen Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Instituti i Gjeoshkencave, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 605, datë 25.10.2023

**PËR MIRATIMIN E TRAJTIMIT
FINANCIAR TË PERSONAVE
PËRGJEGJËS PËR MENAXHIMIN DHE
PERSONAVE PËRGJEGJËS PËR
ORGANET MBIKËQYRËSE TË
OPERATORIT TË SISTEMIT TË
SHPËRNDARJES SHA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “ç”, të pikës 3, të nenit 72, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Trajtimi financiar për administratorin e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes sh.a., të jetë në masën 300 000 (treqind mijë) lekë në muaj.

2. Trajtimi financiar për anëtarët e Këshillit të Administrimit, si persona përgjegjës të organeve mbikëqyrëse të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes sh.a., që kontrollohet nga shteti, të jetë në masën e përcaktuar me vendimin nr. 570, datë 3.10.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për këshillat mbikëqyrës të shoqërive aksionare shtetërore”.

3. Trajtimi financiar i punonjësve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes sh.a., me detyra jomenaxheriale, përcaktohet në përputhje me ligjin e shoqërive tregtare dhe statutin e shoqërisë.

4. Vendimi nr. 574, datë 3.8.2016, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e trajtimit financiar të

personave përgjegjës për menaxhimin e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes sh.a.”, shfuqizohet.

5. Ngarkohet Operatori i Sistemit të Shpërndarjes sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 606, datë 25.10.2023

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN
NR. 595, DATË 13.10.2021, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E
NORMAVE TË TRAJTIMIT ME USHQIM
TË EFEKTIVËVE USHTARAKË TË
FORCAVE TË ARMATOSURA TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “g”, të nenit 11, të ligjit nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 595, datë 13.10.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e normave të trajtimit me ushqim të efektivëve ushtarakë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, bëhen këto ndryshime:

a) Lidhjet nr. 1 dhe nr. 3, të përmendura në pikën 1, zëvendësohen me lidhjet me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

b) Lidhja nr. 2, e përmendur në pikën 2, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

c) Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Personeli ushtarak i strukturave të Forcave të Armatosura, i cili është me shërbim roje dhe i gatshëm në ditët e festave zyrtare, në strukturat e FA-së ku ka ushqim të gatuar, përfiton 500 (pesëqind) lekë shtesë, sipas menysë së miratuar nga vetë strukturat.”.

ç) Shkronja “b”, e pikës 4, shfuqizohet.



2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes.

3. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

Lidhja 1. Tabela e racionit bazë të ushqimit ditor në vlerë kalorike

Nr.	Artikujt ushqimorë	Nj. matëse	Sasia në tri vakte	K/Kalori në trivakte
1	Bukë gruri masive	g	400	1068
2	Koloniale (oriz, makarona)	g	100	366
3	Fasule	g	60	186
4	Mish i freskët viçi	g	150	240
5	Fileto pule	g	115	225
6	Vaj për gatim	ml	30	270
7	Vaj ulliri	ml	20	180
8	Gjalpë	g	30	235
9	Sheqer	g	25	117
10	Sallam ose proshutë	g	70	323
11	Djathë i bardhë	g	70	215
12	Qumësht i freskët/kos i paketuar 200 ml	ml	350	213
13	Vezë	kokërr	2	158
14	Perime për gatim	g	350	130
15	Perime për sallatë	g	350	130
16	Fruta të freskëta	g	400	200
17	Reçel në paketime 20 g	g	20	44
18	Salcë	g	10	0
19	Çaj mali	g	2	0
20	Kripë	g	10	0
21	Erëza	g	2	0
22	Uji i pijshëm	ml	3000	0
Shuma				4300

Lidhja 2. Tabela e artikujve ushqimorë për shtesën 500 kalori

Nr.	Artikulli	Njësia matëse	Sasia	K/kaloritë
1	Djathë kaçavall	g	55	205
2	Çokollata	g	40	211
3	Mish viçi i freskët	g	53	84
Shuma				500



Lidhja 3. Tabela e strukturës ushqimore në vlerë kalorike për vaktin e drekës

Nr.	Artikujt ushqimorë	Nj. matëse	Sasia në një vakt	K/Kalori në një vakt
1	Bukë gruri masive	g	150	400.5
2	Koloniale (oriz, makarona)	g	85	311
3	Fasule	g	0	0
4	Mish i freskët viçi	g	120	192
5	Fileto pule	g	55	107
6	Vaj për gatim	ml	18	162
7	Vaj ulliri	ml	12	108
8	Gjalpë	g	10	77
9	Sheqer	g	0	0
10	Sallam ose proshutë	g	0	0
11	Djathë i bardhë	g	0	0
12	Qumësht i freskët/kos i paketuar 200 ml	ml	0	0
13	Vezë	kokrra	1	78
14	Perime për gatim	g	250	93
15	Perime për sallatë	g	230	85
16	Fruta të freskëta	g	250	125
17	Reçel nëpaketime 20 g	g	0	0
18	Salcë	g	8	0
19	Çaj mali	g	0	0
20	Kripë	g	8	0
21	Erëza	g	2	0
22	Uji i pijshëm	ml	1500	0
Shuma				1738.5

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2023

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 32 lekë